



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



## MOBILE JOURNALISM- FROM CORNERS TO CITIES

# 4 GJËRA PËR TË BËRË NË QYTETIN E VLORËS



Shqipëria ka shumë qytete të bukura ku një ndër ta është ai i Vlorës. Ky qytet është i shquar për monumentet antike dhe pozicionin bregdetar.

### 1) Muzeu Kombëtar i Pavarësisë

Mendoj se njohja e historisë së një vendi ndihmon për ta kuptuar atë. Prandaj, hyra në muzeun e pavarësisë. Aty është një koleksion i madh që tregon historinë e Shqipërisë. Ndodhet pranë portit të Vlorës dhe është hapur në vitin 1936, në vendin ku Ismail Qemali shpalli pavarësinë nga Perandoria Osmane.

### 2) Manastiri i Zvërnecit

Për të arritur në këtë vend duhet të udhëtoni 12 kilometra nga qendra e Vlorës. Manastiri ndahet në një ishull të vogël të lidhur me pyllin në bregdet. Ndërtesa, ndoshta jo e konservuar në mënyrë perfekte, është bizantine. Natyra dhe laguna janë sugjестive për të shijuar një atmosferë të qetë.

### 3) Parku i Llogarasë

Një tjetër vend i mrekullueshëm, jo shumë larg Vlorës, është Parku Kombëtar i Llogarasë. Ai përfshin malet, por mund të vështroni dhe kaltërsinë e detit që shtrohet poshtë jush. Në këtë park ju mund të ecni në natyrë dhe të admironi pamjen unike ose të praktikoni sporte të ndryshme.

### 4) Gadishulli i Karaburunit

Është vendi i përsosur për ata që pëlqejnë zhytjen. Ka shumë lloje peshqish dhe gjithashtu rrënoja të lashta që tashmë janë në fundin e detit. Është një paradaj për t'u vizituar.